



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

KUVENDI / SKUPŠTINA /ASSEMBLY

Legjislatura-III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 04 mars 2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Teutë Hadri, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina dhe Mimoza Ahmetaj. Ndërsa munguan: Rita Hajzeraj, Slllobodan Petroviq dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm ishin:

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës, Nexhat Shatri

Nga OSBE- ja, Petrit Hysa

Nga NDI , Agron Demi

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj dhe Fatime Qorri

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

Komisioni zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2008;
4. Shqyrtimi i P/Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të punës
5. Shqyrtimi i P/Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë
6. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës:

Rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua pa vërejtje

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2008;

Sadik Idriz tha se kemi pranuar një draft të planit për punën e komisionit për vitin 2008. Kemi pas marrëveshjen që ata të cilët kanë propozime konkrete t'i paraqesin me shkrim. Ata që kanë propozime mund t'i prezantojnë këtu, në mënyrë që komisioni sot të përfundojë me planin e punës për vitin 2008. Personalisht nuk kam vërejtje lidhur me planin e punës të prezantuar, sepse P/ligjet e parapara të Qeverisë janë përfshirë në këtë plan. Sa u përket ligjeve nga pakoja e Ahtisarit ato janë deleguar në kompetencë të komisionit Ad Hoc. Gjatë punës është e mundur të bëhet ndryshimi i planit, nëse lind ndonjë çështje urgjente, apo edhe varësisht nga strategjia që është duke u përgatitur.

Kryetari hapi shqyrtimin lidhur me planin e punës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit që të paraqesin propozimet e tyre.

Teutë Hadri propozoi që këtij plani t'i shtohen edhe katër ligje të mandatit të kaluar si ligji për transfuzionin e gjakut, ligji për duhanin, ligji për grevat dhe abortin. Këto janë ligje që janë miratuar dhe është bërë amandamenti i tyre, andaj ajo konsideron që është e një rëndësie të veçantë që këto ligje të futen në planin e punës për vitin 2008. Këtë propozim ajo e dorëzoi edhe me shkrim.

Sadik Idriz tha se këto ligje kanë kaluar leximin e parë dhe të dytë si dhe janë miratuar në Kuvend. Këto ligje nuk mund të kthehen përderisa këtë nuk e bënë Qeveria. Ligji për duhanin është miratuar dhe është nënshkruar nga PSSP-ja. Po ashtu është themeluar këshilli për duhanin, ministria e shëndetësisë e ka fushëveprimtarinë e vet, ministria e tregtisë e ka fushëveprimtarinë e vet, ata duhet të nxjerrin udhëzime administrative, pra ai ligj është miratuar ne vetëm mund të ndërmarrim nismën për ndryshimin e tyre. Ai tha se do të marrë informacion se cilat ligje janë nënshkruar nga PSSP-ja dhe cilat nuk janë nënshkruar.

Agron Demi theksoi se një nga detyrat e asistentëve të NDI është monitorimi i akteve nënligjore. Ai njoftoi komisionin për mundësin e angazhimit të tij si asistent i komisionit që të monitoroj edhe aktet nënligjore që parashihen me ligjin për transfuzionin e gjakut, duhanit, ndërprerjen e shtatzësisë - abortin. Ai theksoi se edhe në mandatin e kaluar ka monitoruar tri ligje.

Nurishahe Hulaj tha se ky plan është përmbajtjesor, dhe konsideroj që nëse komisioni arrin t'i realizoj këto, do të jetë një punë shumë e mirë. Njëherësh ajo sugjeroj që në faqen e dytë ku flitet për objektivat, pika e pestë duhet të ndryshohet, nuk ka nevojë që të jetë “komisioni do të bashkëpunoj me IPVQ-të”, por “Komisioni do të bashkëpunoj me institucionet e Republikës së Kosovës”. Sipas muajve në planin e punës është parapa monitorimi i ligjeve. Është shumë e rëndësishme të bëhet monitorimi i ligjeve, por është mirë që Komisioni të caktoj se cili ligj do të monitorohet, të përcjellim sa udhëzime administrative janë lëshuar, në mënyrë që ligjet të jenë të zbatueshme si p.sh; ligji për shëndet riprodhues të futet në plan për monitorim. Pastaj në planin e punës është paraparë që në maj të mbahet një debat për monitorimin e ligjit. Kosova ka strategjinë për shëndetësinë 2005 -2015 duhet të matim punën se sa është implementuar kjo strategji e cila përfshinë edhe shëndetin publik edhe të gjitha ligjet e tjera nga shëndetësia.

Gjylnaze Sylja tha se nuk ka vërejtje thelbësore në planin e propozuar dhe se ky plan mund të pësoi ndryshime dhe mund të plotësohet varësisht nga plani i Qeverisë. Propozimin e dhënë nga Agron Demi për monitorimin e akteve nënligjore e konsideroi shumë të mirë dhe kërkoi që, asistenti i NDI-së të siguroi raportin për ligjet që ka monitoruar në mandatin e kaluar. Ajo theksoi, që Komisioni duhet të përqendrohet në monitorimin e ligjeve bazike. Pra duhet të ekzistoj një prioritet sa i përket monitorimit të ligjeve.

Mimoza Ahmetaj, tha se plani i punës duhet të ruaj një fleksibilitet që të ketë mundësi që gjatë vitit të bëhen ndërhyrje, si dhe propozoi që me plan të parashihet që deri në qershor të ftohen ministrat e ministrive përkatëse që të përgjigjen në pyetjet e anëtarëve të komisionit. Ajo u pajtua që ligji për shëndetësi publike, ligji për shëndetin riprodhues si dhe ligji për abort të monitorohen nga komisioni, por propozoi që këto ligje të monitorohen paralelisht. Njëherësh ajo parashtroi pyetjen se si do të organizohen vizitat e komisionit.

Sadik Idrizi tha se do të bëjmë një agjendë të vizitave dhe se kjo do të jetë si aneks plan.

Qamile Morina i dorëzoi me shkrim sugjerimet e saj lidhur me planin e punës. Ajo tha se sugjerimet e saj janë bazuar në planin vjetor të punës së Komisionit për SHPMS të mbështetur në strategjinë legjislative të Qeverisë për vitin 2008. Ajo propozoi që komisioni të angazhohet maksimalisht për ndërtimin e infrastrukturës ligjore për themelimin e skemave të sigurimit shëndetësor në Republikën e Kosovës. Gjithashtu ajo propozoi që të ftohet Ministri i Shëndetësisë për ta njoftuar komisionin për planin e makroorganizmit në sistemin shëndetësor për vitin 2008. Në propozimin e saj ajo ka paraparë edhe vizita, sidomos institucionit terciar, pastaj vizitën në QKUK si dhe vizitën në ndonjë institucion social varësisht se për cilin institucion do të përcaktohet komisioni. Sipas saj organizimi i dëgjimeve publike do të ndihmonte shumë në shqyrtimin e P/ligjeve, si dhe propozoi që në planin e punës të parashihet së paku monitorimi i implementimit të një ligji.

Sadik Idrizi tha se Ministria e Shëndetësisë për këtë vit nuk ka parapa ligje në planin strategjik. Arsyeja ka qene sepse ka pas sugjerime që në shëndetësi gjatë këtyre viteve

janë proceduar 12 deri në 13 ligje, pastaj disa ligje do të kthehen në ripunime e që janë ligje bazike. Është sugjeruar që t'i jepet mundësi Ministrisë që të nxjerrë akte nënligjore. Ai vlerësoi si shumë të rëndësishme që në debat të ftohen përfaqësues të Mistrisë që të paraqesin një raport se sa janë zbatuar ato procedura në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe se a janë rregulluar ato kujdestari që parashihen në shëndetësi.

Është shumë e rëndësishme që në debat të ftojme përfaqësues nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sepse ato ligje do të vijnë shumë shpejt si psh; ligji për skemën sociale, pastaj ligji për invaliditetin në punë. Do të organizohen dëgjime publike dhe me siguri do të kemi mbledhje të përbashkët me Komisionin për Bujqësi, ku do të shqyrtojmë P/ligjin për ushqimin, me siguri do të ketë probleme sa i përket kompetencave. Pastaj, nuk mund të shqyrtojmë P/ligjet e të mos ftojme ata përfaqësues për të cilët ato P/ligje dedikohen.

Gjylnaze Sylja tha se konkluzioni i kësaj mbledhjeje për këtë rend dite është që për mbledhjen e ardhshme ta kemi raportin e NDI-së për aktet nënligjore, si dhe në cilën fazë të procedurës janë ligjet nga shëndetësia, puna dhe mirëqenia sociale.

Flora Brovina, tha se ka qenë një praktikë e mirë që një ose dy anëtarë të komisionit të marrë dhe të përpunoj ligjet, të nxjerrë sugjerime dhe t'i dorëzoj te anëtarët e tjerë të komisionit, në mënyrë që të debatohet pastaj nen për nen për ato ligje.

Kryetari i komisionit, konstatoi që plani i punës u miratua, me inkorporimet që do të bëhen nga propozimet e parashtruara në mbledhjen e komisionit..

4. Shqyrtimi i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të punës

Sadik Idriz theksoi se ky projektligj ka qenë edhe në mandatin e kaluar, është shqyrtuar dhe të gjitha ndryshimet në të kanë të bëjnë me formimin e Agjencionit Ekzekutiv kjo ka implikime buxhetore, por kjo nuk është çështje e këtij Komisioni. Nëse do të ketë vërejtje atëherë do të ketë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ky P/ligj ka gjashtë nene që janë propozuar për ndryshim dhe ato janë te terminologjia. P/ligji ka kaluar shqyrtimin e parë, ne do të marrim transkriptin se çka është vënë në dukje në seancën plenare. Ai tha se e hapi shqyrtimin për këtë P/ligj dhe jam i mendimit që sot të caktojmë një raportues i cili do të merret me shqyrtimin e hollësishëm të tij. Ky raportues për mbledhjen e ardhshme do të paraqes vërejtjet apo ndonjë amandamentet. Gjithashtu edhe anëtarët e komisionit mund t'i paraqesin ato.

Mimoza Ahmetaj kërkoi të informohet nga anëtarët e komisionit se si është bërë procedimi i këtyre ligjeve dhe propozoi që gjatë diskutimit të P/ligjeve të ftohen edhe përfaqësuesit e ministrive përkatëse, në rastin konkret përfaqësuesit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale. Ndërsa, për ligjet të cilat kanë implikime buxhetore në mbledhje të ftohet edhe dikush nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ajo kërkoi që komisionit t'i dorëzohet edhe transkripti nga mbledhjet e Kuvendit në mënyrë që të merret për bazë edhe ajo se çfarë kanë propozuar deputetët për ndryshim në këto ligje.

Teutë Hadri, propozoi që të caktohen raportuesit në mënyrë që komisioni të filloj me funksionimin e punës.

Gjylnaze Sylja kërkoi njoftim nga stafi mbështetës nëse ka raporte me rekomandime për këto projektligje që janë në rend dite.

Armend Zemaj propozoi që të caktohen raportuesit në mënyrë që të përshpejtohen procedurat pasi që është fjala për ndryshim-plotësim të ligjeve.

Nurishahe Hulaj njoftoi lidhur me arsyetimin e ministrisë për plotësim dhe ndryshim të këtij ligji. Ajo theksoi se në mandatin e kaluar ministria nuk ka dhënë arsye bindëse se pse duhet të bëhen këto ndryshime. Ky propozim ka implikime buxhetore, ne mund të shkojmë nën për nën dhe ne pastaj do të vendosim a do të jetë Agjencion apo Inspektorat.

Sdik idriz, propozoi që për P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të punës raportuese të jetë Gjylnaze Sylja dhe për mbledhjen e ardhshme do të debatohet nën për nën. Dhe ne do të marrim vendim për këto propozime.

Flora Brovina njoftoi anëtarët e komisionit për takimet lidhur me përfaqësuesit e Ministrisë dhe për arsyetimin e tyre jo bindës lidhur me themelimin e Agjencionit.

Armend Zemaj konsideroj që është e nevojshme që prapë të dëgjojmë propozuesit se çka është konfuze për ta në këtë ligj.

5. Shqyrtimi i P/Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Sadik Idrizi propozoi që edhe për këtë projektligj të caktohen raportues, të cilët në mbledhjen e ardhshme do të paraqesin mendimet e tyre. Ndërsa për javën e ardhshme për këto dy projektligje do të ftohen përfaqësuesit e ministrive përkatëse në mënyrë që të dëgjohen edhe arsyet e tyre.

Raportues për P/Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë komisioni caktoi Mimoza Ahmetaj dhe Nurishahe Hulaj

6. Të ndryshme

Gjylnaze Sylja propozoi që kryetari i komisionit të drejtohet kryesisht së Kuvendit me një letër me të cilën do të kërkoi mbështetje të ekspertizës për amandamentimin e ligjeve. Ajo tha se të gjithë anëtarët e Komisionit janë mjek me profesion, andaj kemi nevojë për mbështetje profesionale nga jashtë Kuvendit.

Sadik Idrizi tha që në këtë fazë nuk ka nevojë. Nëse më von paraqitet ndonjë problem që të kërkohet kjo, njëherësh ai theksoi se juristet nga jashtë nuk kanë të drejtë të bëjnë amandamente, sado të jenë profesionist, eventualisht nëse komisioni angazhon ekspert

për propozimet e të cilëve vendos pastaj komisioni. Konsideroi, që si propozim do të merret për bazë por sot nuk do të vendoset lidhur me këtë.

Flora Brovina theksoi se ky komision edhe në mandatet e kaluara ka pasur përkrahje si nga stafi i Kuvendit ashtu edhe nga NDI, pastaj po ky komision ka angazhuar edhe ekspert por kjo ndodhë varësisht nga situata.

Mbledhja e radhës do të jetë të martën e ardhshme në ora 11:00

Kryetari e shpalli mbledhjen e mbyllur në ora 12:09

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz